



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:197927

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06521477

KPPP.nr. 1075/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Rruga Qamil Hoxha nr.51, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbëresh”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “A.J” B.I, me numër unik identifikues ... dhe seli në Podujevë, Rruga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Kajtazi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 583/24 të datës 03.06.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Agron Krasniqi me zyre në Ferizaj, jashtë seancës, me datën 27.11.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “A.J” B.I, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 583/24 i datës 03.06.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Agron Krasniqi, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 EUR (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me datë 03.06.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 583/24 duke lejuar përmbartimin ndaj debitorit A.J” B.I, mbi bazë të dokumentit të besueshëm: Faturë nr. 06897/12-2021 e datës

09.12.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,666.75 EUR (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e shtatëdhjetë e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej datës së mos pagesës e deri në ditën e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se i njëjti është i pabazuar dhe në kundërshtim me nenin 27 dhe nenin 71, par. 1.6 dhe par. 1.7 të LPP-së. Shton se dokumenti nuk mund të jetë i pambarueshëm për faktin se në urdhrin për përmbarim nuk është treguar koha e përbushjes së detyrimit, me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se e ka bërë të kërkueshëm borxhin dhe nuk ka paraqitur deklaratë të kërkueshmerisë së borxhit, në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së. Shton se debitori e ka të shuar biznesin që nga data 11.03.2022 dhe përmbarimi nuk mund të zbatohet pasi që i njëjti nuk ka subjektivitet juridik. Andaj, i ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet dhe urdhri për përmbarim të anulohet.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se urdhri përmbarimor është i ligjshëm sepse i njëjti është bazuar në dokumentin e besueshëm, ku është caktuar koha e përbushjes, duke u cekur që “Pagesa e faturës të bëhet menjëherë”. Shton se sa i përket pretendimit të debitorit që i njëjti ka shuar biznesin para kohës së dërgimit të lëndës në përmbarim, debitori është biznes individual dhe sipas nenit 48, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i njëjti nuk është person juridik dhe ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera. Tutje ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe se nuk i plotësojnë asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së. Andaj, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhrin përmbarimor ta aprovoj, si dhe i ka kërkuar shpenzimet për përgjigjen në prapësim në shumën prej 104.00 EUR.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij

neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 06897/12-2021 e datës 09.12.2021 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbardimi ndaj debitorit, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit dhe vula e biznesit të tij e evidentuar tek pranuesi i faturës, e po ashtu fatura i është bashkëngjitur propozimit për përmbardim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbardimit pasi që janë të përshtatshme për përmbardim.

Në vlerësimin e pretendimeve të debitorit, gjykata gjeti se nuk plotësohen asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbardimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’u njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 78.00 EUR, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës, nr. tarifor 6, lidhur me përpilimin e parashtrësve tek çështjet përmbardimore në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1075/24, datë 27.11.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.